

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874 datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të procesit të konsultimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874 datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”, mirëpret sugjerimet nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme ligjore.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 24 shtator 2025 deri në datë 25 Nëntor 2025.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me anë të:

1. Regjistrin elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>,
2. Në adresën postare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Rruga e Kavajës 25, Tiranë 1001
3. Në adresën e kordinatorit për konsultimin publik, Vojsava.Gjoliku@shendetesia.gov.al

si dhe nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit që eventualisht mund të zhvillohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Kontakti:

Edra Bezati, Përgjegjës Sektori i Farmaceutikës në Ministri: Edra.Bezati@shendetesia.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 24 Shtator 2025.

Sfondi i propozimit legjislativ

Qëllimi kryesor i këtij projektakti është përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues që rregullon kontrollin e lëndëve që përdoren në mënyrë të paligjshme për prodhimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope. Ky përmirësim vjen si nevojë për përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, si dhe për forcimin e mekanizmave të parandalimit dhe kontrollit në kuadër të luftës kundër trafikut të paligjshëm të drogës.

Objektiv specifik që synohet të arrihet me këtë projektakt është përditesimi i listës së lëndëve që përdoren në mënyrë të paligjshme për prodhimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të krijohet një kuadër më efikas dhe i harmonizuar me

standardet ndërkombëtare, duke garantuar kontroll të rreptë mbi prodhimin, importin, eksportin, transportin dhe përdorimin e lëndëve që mund të përdoren për qëllime të paligjshme.

Propozimet

Projektligji përbëhet në tërësi nga 5 nene, nëpërmjet të cilave bëhen disa shtesa dhe ndryshime në dispozitat e neneve të caktuar në ligjin nr.8874 datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”
Neni 1 i projektligjit parashikon që, në Nenin 2 pas gërmës “h” shtohen gërmat “i”, “j”, “k” dhe “l” si vijon:

i). “Lëndë jo e listuar” do të thotë çdo lëndë e cila, edhe pse nuk është e përfshirë në Aneks, është identifikuar si e përdorur për prodhimin e paligjshëm të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope.

j). “Eksportues” do të thotë personi fizik ose juridik që është përgjegjës kryesor për veprimtaritë e eksportit, në bazë të marrëdhënies ekonomike dhe ligjore me lëndët e listuara dhe me marrësin, dhe, kur është e nevojshme, ai që paraqet deklaratën doganore ose në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore.

k). “Importues” do të thotë personi fizik ose juridik që është përgjegjës kryesor për veprimtaritë e importit, në bazë të marrëdhënies ekonomike dhe ligjore me lëndët e listuara dhe me dërguesin, dhe që paraqet deklaratën doganore ose në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore.

l) “Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve (INCB)” do të thotë organi i krijuar nga Konventa e Vetme mbi Lëndët Narkotike e vitit 1961, e ndryshuar me Protokollin e vitit 1972.

Nëpërmjet kësaj shtese përkufizimi synohet të mirëpërcaktohet kuptimi i disa termave të rëndësishëm, në mënyrë që ligji të zbatohet më saktë dhe të jetë në përputhje me rregullat ndërkombëtare për kontrollin e lëndëve që mund të përdoren për prodhimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Neni 2 i projektligjit parashikon një shtesë në nenin 11 si vijon:

Operatori duhet të marrë një deklaratë të veçantë për secilën substancë të listuar. Kjo deklaratë duhet të jetë në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcën 7. Nëse operatori furnizon rregullisht të njëjtin klient me substanca të kategorisë 2, ai mund të pranojë një deklaratë të vetme vjetore, nëse klienti:

- a) klienti është furnizuar nga operatori me substancën të paktën tre herë gjatë 12 muajve të fundit;
- b) operatori nuk ka arsye të mendojë se substanca do të përdoret për qëllime të paligjshme;
- c) sasi të e porositura janë në përputhje me konsumin e zakonshëm të klientit.

Kjo deklaratë duhet të jetë në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcën 7/1 të këtij ligji

Nëpërmjet kësaj shtese synohet të forcohet kontrolli mbi përdorimin dhe qarkullimin e substancave të listuara, duke siguruar që operatorët të kenë dokumentacion të rregullt për klientët dhe qëllimin e përdorimit të lëndëve. Kjo ndihmon në parandalimin e devijimit të substancave drejt përdorimeve të paligjshme.

Në nenin 3 i projektligjit parashikon ndryshimin e pikës 4, të nenit 18, me këtë përmbajtje:
4) Dokumentacioni i përmendur në pikat 1 dhe 3 ruhen për një periudhë prej 3 vjetësh, duke filluar nga fundi i vitit kalendarik, në të cilin është kryer operacioni i përmendur në pikën 1 dhe duhet të jete i disponueshëm për inspektim nga organet përgjegjëse, sipas kërkesës së këtyre të fundit. Ky dokumentacion duhet të organizohet në mënyrë të tillë, në formë elektronike ose në letër, që të jetë lehtësisht i disponueshëm për inspektim nga autoritetet kompetente me kërkesë.

Dokumentacioni mund të ruhet në formë imazhi ose në një mjet tjetër elektronik të ruajtjes së të dhënave, me kusht që, kur të bëhet i lexueshëm, të përputhet në pamje dhe përmbajtje me dokumentacionin origjinal, të jetë gjithmonë i aksesueshëm, të mund të lexohet pa vonesë dhe të analizohet me mjete automatike.

Kjo shtesë bëhet me argumentin se është e rëndësishme që dokumentacioni të ruhet dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm për autoritetet, për të mundësuar kontrolle të sakta dhe të shpejta. Përdorimi i formës elektronike e bën procesin më efikas dhe ndihmon në mbajtjen e të dhënave në përputhje me me ligjet dhe standardet ndërkombëtare.

Në nenin 4 parashikohen ndryshimi i Shtojcës 1 dhe Shtojcës 4.

Neni 5 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit.

Pyetjet

Çështjet kryesore që mendojmë se duhet të diskutohen lidhur me këtë nismë ligjore janë:

- A mendoni se shtesat dhe ndryshimet e propozuara në përmbajtjen e projektligjit **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874 datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”**, përmirësojnë përmirësojnë kuadrin ligjor duke e bërë më efektiv kontrollin dhe parandalimin e përdorimit të paligjshëm të lëndëve narkotike?
- A mendoni se ka elementë të tjerë që duhet të shtohet apo ndryshojnë në këtë projektligj?